



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**  
*Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice*

**Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar**  
**në çështjet penale mundësitë dhe**  
**sfidat**

Armend Hamiti

Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë

Gazmend Çitaku-Drejtor

Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar

Ministria e Drejtësisë

Prishtinë, mars 2023

## Tabela e përmbajtjes

Hyrje .....	4
Objektivat trajnuese .....	4
Metodologjia trajnuese .....	4
Pritjet nga pjesëmarrësit .....	4
<b>1. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale si mjet për zbatimin e Drejtësisë.....</b>	<b>5</b>
1.1 Çka është Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar .....	5
1.2 Pse nevojitet bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale .....	5
<b>2. Korniza institucionale/Historiku i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në Kosovë.....</b>	<b>5</b>
2.1 Roli dhe përgjegjësitë e Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.....	6
2.2 Roli dhe përgjegjësitë e Koordinatorit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Prokurori .....	7
2.3 Roli dhe përgjegjësitë e Koordinatorit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar ne Gjykata .	7
2.4 ILECU-Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit te Ligjit .....	7
2.5 Zyra e UNMIKUT.....	8
2.6 Rrjeti Gjyqësor Evropian (EJN) .....	9
<b>3. Baza ligjore e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale në Kosovë.....</b>	<b>9</b>
3.1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës .....	9
3.2 Marrëveshjet bilaterale për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale Marrëveshjet Dypalëshe .....	10
3.3 Ligji nr. 08/I-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/I-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale .....	12
3.3.1 Kufizimet e Bashkëpunimit.....	12
3.3.2 Format e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale.....	13
<b>4. Ekstradimi .....</b>	<b>13</b>
4.1 Hyrje - Koncepti dhe konsiderata të përgjithshme.....	13
4.3.1 Arrestimi i përkohshëm para pranimit të kërkesës për ekstradim .....	14
4.3.2 Çfarë është “ RED NOTICE” - njoftimi i kuq? .....	14
4.3.3 Çfarë është urdhër arresti evropian ?.....	15
4.4 Shqyrtimi dhe vendimi faza e ekstradimit.....	15
4.5 Procedura gjyqësore për ekstradim në Kosovë.....	16
4.6 Procedura e thjeshtësuar për ekstradim.....	17
4.7 Bazat ligjore për ekstradim.....	17

4.8	Vendimi për lejueshmërinë apo mos lejueshmërinë e ekstradimit.....	17
4.9	Ekstradimi dhe gjykimet në mungesë .....	17
5.	Letër-rreshtimet Ndërkombëtare .....	17
5.1	Kërkimi i adresës së të pandehurit .....	18
5.2	Kushtet për dhënien e letër-rreshtimit.....	18
5.3	Shpalljet Publike .....	18
5.4	Tërheqja e letër-rreshtimit ose e shpalljes publike.....	18
5.5	Shpallja e letër-rreshtimit ose kërkesës për informata nga publiku .....	19
5.6	Procedurat për lëshimin e Urdhër Kërkimit Ndërkombëtar.....	19
6.	Transferimi i procedurave penale.....	20
7.	Ekzekutimi i dënimeve të huaja: Transferimi i personave të dënuar .....	20
8.	Njohja e vendimeve penale të huaja .....	20
9.	Ndihma e ndërsjellë ligjore në çështjet penale .....	20
9.1	Çfarë është ndihma e ndërsjellë ligjore?.....	20
9.2	Format kryesore të ndihmës së ndërsjellë juridike.....	21
9.3	Bazat ligjore për ndihmë ligjore të ndërsjellë.....	22

## **Hyrje**

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar paraqitet si nevojë në këto kohë moderne meqë krimi i ka tejkaluar kufijtë e brendshëm dhe ka marrë dimension ndërkombëtar. Në këtë botë gjithnjë e më të ndërvarur, asnjë vend nuk mund të luftoj krimin në mënyrë efektive pa bashkëpunim mes shteteve për të parandaluar dhe për të zbuluar krimin. Kështu që është e një rëndësie të madhe aftësia e shteteve për të ndihmuar njëri-tjetrin shpejt dhe në mënyrë efikase.

Që të arrihet kjo nevojitet ndihma juridike ndërkombëtare si më specifike apo bashkëpunimi juridik ndërkombëtar si term më i gjerë. Ndihma juridike ndërkombëtare nga natyra e saj është një veprim i organit shtetëror pas kërkesës për ndihmë juridike të shtetit tjetër, siç parashihet me marrëveshjen ndërkombëtare të lidhur në mes të këtyre shteteve.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në çështjet penale realizohet përmes lidhjes ndërmjet dy ose më shumë shtete, ku një shtet i cili ka nevojë për asistencë ligjore është shteti kërkues dhe shteti tjetër që merr kërkesa për ndihmë juridike është shteti i kërkuar.

Gjatë prezantimit të këtij trajnimi do të paraqiten njohuritë themelore për të kuptuar se çka është bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale. Prezantimi do t'i ofroj pjesëmarrësve të kuptojnë rolin dhe rëndësinë e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

Pjesëmarrësit gjatë pjesës së ushtrimeve do të shohin shembuj të formave nga praktika kur kërkohet bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

## **Objektivat trajnuese**

Në përfundim të këtij trajnimi pjesëmarrësit do të jenë në gjendje:

- të njohin bazën ligjore të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në Kosovë;
- të zbatojnë dispozitat ligjore lidhur me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale
- të mësojnë rëndësinë e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale të dinë rolin e tyre për veprim të shpejtë tek rastet me bashkëpunim juridik ndërkombëtar;
- të jenë në gjendje të aplikojnë ligjet e duhura në bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale.

## **Metodologjia trajnuese**

Për këtë trajnim do të shfrytëzohen metodat e mëposhtme:

- Ligjërime – prezantim në PowerPoint;
- Diskutime në grupe;
- Ushtrime në grupe –detyre praktike;
- Marrja e mendimeve praktike;
- Provimi përfundimtar me shkrim.

## **Pritjet nga pjesëmarrësit**

- Marrja pjesë aktive në diskutimet në grupe;
- Marrja pjesë aktive në ushtrimet në grupe;

- Përgatitja – leximi i materialit të dhënë;
- Zbatimi i njohurive të fituara në punën e tyre të përditshme me rastet me bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

## **1. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale si mjet për zbatimin e Drejtësisë**

### **1.1 Çka është Bashkëpunimi Juridik Ndërkombëtar**

Çfarë është bashkëpunimi?

Bashkëpunimi është përpjekje e përbashkët e një grupi për përfitimin e tyre reciprok.

Bashkëpunimi është puna ekipore.

Bashkëpunimi arrihet duke punuar së bashku në mënyrë paqësore.

**Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar** është bashkëpunimi i personave apo grupeve të personave që përfaqësojnë shtete të ndryshme në ndjekje të një qëllimi të përbashkët.

**Bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale** është çdo formë e ndihmës e kërkuar apo e ofruar nga një shtet tjetër, organizatë apo institucion, me qëllim të mbështetjes së procedurave penale.

### **1.2 Pse nevojitet bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale**

Si pasojë e përparimeve teknologjike të transportit, teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit, të cilat e kanë bërë botën “një qytet të vetëm e të madh”, krimi nuk është më një fenomen kombëtar, por ka marrë një dimension ndërkombëtar.

Për shkak të natyrës së saj ndërkombëtare, të gjitha format e krimit të organizuar ndërkombëtar, paraqesin probleme serioze për sistemet kombëtare të drejtësisë.

Është e vështirë për zbatuesit e ligjit në një vend për të hetuar apo përfunduar procedura penale kundër personave të dyshuar për pjesëmarrje në aktivitete kriminale, kur personat e tillë janë jashtë territorit të tyre, ose ku prova kyçe, dëshmitarët, viktimat apo të ardhurat nga krimi janë të vendosur jashtë juridiksionit të vendit, ose kur sistemet ligjore dhe gjyqësore me të cilat ata duhet të bashkëpunojnë janë të ndryshme nga ato të vendit të tyre. Megjithatë, zbatuesit e ligjit në një vend realisht nuk mund të punojnë brenda kufijve kombëtarë. Ata nuk kanë zgjidhje, por për të bashkëpunuar me homologët e tyre të huaj në mënyrë që të sjellin autorët e këtyre veprave para drejtësisë. Efikasiteti i luftës kundër krimit varet nga bashkëpunimi i ngushtë midis shteteve në çështjet penale.

## **2. Korniza institucionale/Historiku i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në Kosovë**

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar mund të themi se është paraqitur kohëve të fundit si domosdoshmëri e kohës pasi krimi i ka tejkaluar kufijtë e brendshëm dhe ka marrë dimension ndërkombëtar. Andaj edhe në Kosovë është ende diçka e re dhe mund të themi jo e trajtuar si diçka parësore por ende shihet si diçka jo shumë e rëndësishme si punë dytësore.

## 2.1 Roli dhe përgjegjësitë e Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar

Fusha e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar ka qenë kompetencë plotësisht e rezervuar e Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut, deri më datën 20 mars 2009. Ministria duke iu përshtatur rrethanave të reja juridike dhe politike pas shpalljes së pavarësisë së Republikës të Kosovës me datë 17 shkurt 2008, ka marr kompetencat sa i përket fushës së bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile.

Me këtë rast Ministria ka nxjerre udhëzimin administrativ mbi ofrimin e ndihmës juridike ndërkombëtare në fushën e çështjeve penale dhe civile, me të cilin udhëzim në përputhje me rrethanat e reja të krijuara dhe ligjin e aplikueshëm penal në Kosovë, ka marr të gjitha obligimet dhe përgjegjësitë sa i përket ndihmës juridike ndërkombëtare nga Departamenti i Drejtësisë së UNMIK-ut, për të gjitha shtetet që kanë njohur shtetin e Kosovës.

Gjatë shtatorit të vitit 2009, Ministria ka plotësuar udhëzimin administrativ të datës 20 mars 2009, dhe ka shtrirë kompetencat e saja sa i përket bashkëpunimit juridik ndërkombëtar edhe për të gjitha shtetet tjera të cilat nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës.

Në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës ekziston Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar i cili është ndarë në dy Divizione (Divizioni për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile dhe Divizioni për hartimin dhe negocimin e marrëveshjeve bilaterale). Ky departament udhëhiqet nga Drejtori i Departamentit dhe ka mandat të siguroj procedimin e të gjitha kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare në çështje të cilat janë në fushëveprimin e përgjegjësive të tij si më poshtë:

- Hartimin, negocimin dhe arritjen e lidhjes së Marrëveshjeve bilaterale në mes Kosovës dhe shteteve të huaja sa i përket bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile;
- Propozimin dhe përgatitjen për nënshkrim të konventave ndërkombëtare që i përkasin fushës së bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile;
- Propozimin e hartimit të legjislacionit primar dhe sekondar lidhur me fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile;
- Kryen hulumtime ligjore në çështjet e politikave ligjore që kanë të bëjnë me ligjin e zbatueshëm në Kosovë lidhur me fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile;
- Autoritet qendror për territorin e republikës së Kosovës lidhur me përfaqësimin e autoriteteve gjyqësore dhe prokuroriale në raport me shtetet e huaja;
- Shqyrtimin dhe procedimin e të gjitha llojeve të kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare, në përputhje me ligjin dhe procedurat në fuqi;
- Bashkëpunon në mënyrë të ndërsjellë me gjykata, prokurori, policinë e Kosovës; zyrën e këshilltarëve ligjorë të kryeministrit; ministrinë e punëve të jashtme të Kosovës; ambasadat dhe konsullatat e Kosovës në botë; ambasadat dhe zyrat ndërlidhëse të shteteve të huaja në Kosovë; Interpol, konferencën e Hagës mbi të drejtën ndërkombëtare private dhe çdo institucion vendor dhe ndërkombëtar që ndërlidhet me fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale dhe civile;
- Harton memorandume për rreshtime ndërkombëtare, memorandume për ekstradim, kërkesat për transferim të personave të dënuar;
- Autoritet qendror për territorin e republikës së Kosovës për shqyrtimin dhe procedimin e rasteve të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve, (Ligji mbi aspektet civile kundër rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve);
- Procedimin e kërkesave për vërtetimin e autorizimeve të lëshuara nga gjykatat e vendeve të rajonit, që kanë të bëjnë me transaksionet pronësore në Kosovë;
- Këshillon ministrin e drejtësisë lidhur me zhvillimin e politikave që i përkasin bashkëpunimit juridik ndërkombëtar;

- Dhënia e opinioneve ligjore për autoritetet vendore dhe ato te huaja lidhur me ligjin e aplikueshëm ne Kosove qe i përkasin fushës se bashkëpunimit juridik ndërkombëtar ne çështjet penale dhe civile; dhe
- Kryen çdo detyrë tjetër që përfshihet në mandatin e departamentit për bashkëpunim juridik ndërkombëtar, në përputhje me ligjin e aplikueshëm ne Kosovë.

## **2.2 Roli dhe përgjegjësitë e Koordinatorit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Prokurori**

Nga 28 shkurti i vitit 2013, me vendim nr.271/13 nga Zyra e Kryeprokurorit te Shtetit me qëllim të ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësiwe të tij në mënyrë më efikase në rastet që ndërlidhen me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale, ka caktuar nëpër çdo prokurori themelore të Kosovës, koordinatorin i cili do të jetë kompetent për adresimin e rasteve që pranohen nëpër prokuroritë kompetente. Me vendimin KPK. Nr 270/13 të datës 27 dhjetor 2013 Këshilli Prokurorial i Kosovës e ka caktuar për Prokurorin e shtetit pikën e kontaktit për EUROJUST dhe EJM, nga muaji qershor i vitit 2016 për here te pare ka filluar te prezantoj ky prokuror ne takimet e EJM.

## **2.3 Roli dhe përgjegjësitë e Koordinatorit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar ne Gjykata**

Nga muaji Maj 2013 nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës me qëllim të ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësiwe të tij në mënyrë më efikase në rastet që ndërlidhen me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale, ka caktuar nëpër çdo Gjykate themelore të Kosovës, koordinatorin i cili do të jetë kompetent për adresimin e rasteve që pranohen nëpër gjykatat kompetente.

## **2.4 ILECU-Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit te Ligjit**

Drejtoria për bashkëpunim ndërkombëtar - ILECU është themeluar në vitin 2011 me vendim të Qeverisë së Kosovës.

Në mënyrë që kjo Drejtori të jetë funksionale, është nënshkruar marrëveshja në mes të MPB-së, MD-s, Kryeprokurorit të Shtetit dhe Ministrisë së Financave , ku me pas janë caktuar edhe pikat tona të kontaktit në secilën Ministri dhe ky bashkëpunim vazhdon edhe sot.

Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje ILECU, përveç pikave te kontaktit me secilin institucion , ne zyrën e ILECU ne te njëjtën zyre me zyrtaret e Policisë se Kosovës , punojnë edhe një zyrtar i Doganës, dhe një nga Shërbimi Korrektues, te cilët shërbejnë si zyrtare ndërlidhës te deleguar ne ILECU

ILECU, si rrjet ekziston nga Kosova e deri në Moldavi, me idenë që të zgjerohet edhe në Gjeorgji e Ukrainë. Standardi i punës ne te gjitha këto shtete është pothuaj se njësoj, SOP janë pothuajse të njëjta, ndërsa strategjitë dhe planet e veprimit janë po ashtu gati të njëjta.

ILECU në përbërjen dhe organizimin e vet ka katër sektorë : Sektorin për INTERPOL, sektorin për EUROPOL, sektorin për SELEC, sektorin për FAST, dhe sektorin për ARMË apo Pika Kombëtare për Armë.

Drejtoria për bashkëpunim ndërkombëtar ne kuadër te saj ka edhe zyrtaret ndërlidhës te Policisë se Kosovës te akredituar ne shtetet tjera, ku deri me tani kemi 7 zyrtare ndërlidhës policor te akredituar në : Belgjikë, Gjermani, Austri, Turqi, France, SHBA dhe Zvicër.

Drejtoria për bashkëpunim ndërkombëtar, është pike kontakti edhe për ndërlidhësit policor te vendeve tjera të akredituar në Kosovë, respektivisht për shtetë Nordike, Gjermaninë, Zvicrën, Italinë, Francën, Britaninë e Madhe, Vendet e Benelux-it etj.

Drejtoria për bashkëpunim ndërkombëtar është pike kontakti edhe e disa organizatave ndërkombëtarë siç janë SEEFEG, SEEFEN, OLAF dhe ENFAST.

Nga viti 2008 e deri me tani Kosova ka nënshkruar 72 Marrëveshje për Bashkëpunim Policor me 18 shtete. Nga këto 72 Marrëveshje, 27 mbulojnë Bashkëpunimin e Përgjithshëm Policor, 27 Bashkëpunimin Ndërkufitar, 8 nga aspekti i Operativës dhe 10 Marrëveshje mes Policisë së Kosovës dhe EULEX-it.

Në Ballkanin Perëndimor ky organizim është i njohur si ILECU e në shtetet e BE-s si SPOC (Single Point of Contact) ku në fakt ky do të jetë si “kabine” për shkëmbim të informacioneve apo “qendër Operative” ku të dhënat vijnë nga linja të ndryshme komunikimi si eASF ose SIRENE ose SIENA ose INTRANET dhe kthehen në të njëjtën formë.

Marrëveshjet që nënshkruan Ministria e Drejtësisë kanë efekt edhe në Policinë e Kosovës në përgjithësi dhe në punën e ILECU-t në veçanti.

Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar në mandat të saj ka koordinimin e komunikimeve që ndërlidhen me Ministrinë e Drejtësisë dhe Njësi operative në kuadër të PK-ës dhe atë për asistimin mbi Ekstradim, Transferim dhe Deportim të shtetaseve tanë nga vendet tjera për në Kosovë dhe anasjelltas.

## **2.5 Zyra e UNMIKUT**

UNMIK ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit me INTERPOL që nga viti 2002 dhe funksionon si zyre qendrore kombëtare, ndërsa në INTERPOL e ka statutin e vëzhguesit në Asamblesë të Përgjithshme të INTERPOL-it.

UNMIK INTERPOL është e ndarë fizikisht me zyre dhe komunikimi me ILECU bëhet në formën që UNMIK e ka linkun I 24/7 dhe ata e vendosin se cilat informata janë për ILECU e cilat jo.

Momentalisht në zyrat e INTERPOL UNMIK janë të vendosur fizikisht 3 zyrtar të UNMIK-ut dhe 4 të EULEX-it.

Policia e Kosovës nuk është pronare e informatave dhe si pasojë e kësaj komunikimi merr kohë (në momentin që kemi ndërmjetësim atëherë kjo paraqet vonesë).

Policia e Kosovës kishte marr pjesë në Konferencat e Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it (vitin 2014 në Monako), Konferencën e INTERPOL-it Evropian (në Maj të 2015) të shfaqur te INTERPOL-it Evropian apo në ndonjë operacion të përbashkët ku përdoren kanalet e INTERPOL-it (por në këto takime marrin pjesë edhe përfaqësues të UNMIK-ut), ndërsa tani Policia e Kosovës nuk merr pjesë në takime me UNMIK INTERPOL.

Rastet që vijnë nga UNMIK INTERPOL përbejnë 40-42% të rasteve që në total i ka ILECU. ILECU përdor gati në 60% të rasteve kanale të tjera të komunikimit (ose zyrtarët tonë ndërlidhës të akredituar jashtë shteti ose zyrtarët e huaj të akredituar në Kosovë apo drejtpërdrejt ILECU)

Në vitin 2015 EULEX ka financuar një projekt ku dy ekspert të fushave të IT dhe të Mbrojtjes së të dhënave personale kanë ardhur në Kosovë dhe kanë bërë vlerësim të situatës në Policinë e Kosovës. Rekomandimi i tyre ishte që Kosova i ka kapacitetet njerëzore, teknike dhe Ligjore që të lidhet me linkun e INTERPOL-it dhe këtë mund ta bëjë brenda një jave.

Kosova ka aplikuar në INTERPOL dhe ende nuk është pranuar.

Sidoqoftë, në konsiderojmë që Kosova i ka modalitetet e komunikimit me INTERPOL edhe pse në kërkime që të lidhim marrëveshjen strategjike dhe Operacionale sepse në këtë mënyrë ne do të ishim pronar, llogaridhënës dhe përgjegjës për punën tonë dhe bashkëpunimin me këtë Organizatë.



## 2.6 Rrjeti Gjyqësor Evropian (EJN)

Rrjeti Gjyqësor Evropian (EJN) është një rrjet i pikave kombëtare të kontaktit për lehtësimin e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale. EJN u krijua nga Aksioni i Përbashkët 98/428 JHA i 29 qershorit 1998 për të përmbushur rekomandimin nr.21 të Planit të Veprimit për Luftimin e Krimit të Organizuar të miratuar nga Këshilli më 28 Prill 1997.

Në dhjetor 2008, një bazë e re ligjore hyri në fuqi, Vendimi i Këshillit 2008/976/JHA i datës 16 dhjetor 2008 mbi Rrjetin Gjyqësor Evropian (më tej “Vendimi i EJN”), i cili përforcoi statusin ligjor të EJN-së, duke ruajtur frymën të vitit 1998.

EJN përbëhet nga pika kontakti në Shtetet Anëtare të përcaktuara nga çdo Shtet Anëtar midis autoriteteve qendrore përgjegjëse për bashkëpunimin gjyqësor ndërkombëtar dhe autoriteteve gjyqësore ose autoriteteve të tjera kompetente me përgjegjësi specifike në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar.

Kosova përfaqësohet që nga viti 2016 është pjesë aktive në këtë rrjet.

Roli kryesor i Pikave të Kontaktit të EJN-së, të përcaktuara nga Vendimi i EJN-së si “ndërmjetësues aktivë”, është të lehtësojnë bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale ndërmjet shteteve anëtare të BE-së, e poashtu edhe shteteve të Evropës që nuk janë anëtare të BE-se, veçanërisht në veprimet për të luftuar format e krimit të rëndë. Për këtë qëllim, ata ndihmojnë në vendosjen e kontakteve të drejtpërdrejta ndërmjet autoriteteve kompetente dhe duke ofruar informacion ligjor dhe praktik të nevojshëm për të përgatitur një kërkesë efektive për bashkëpunim gjyqësor ose për të përmirësuar bashkëpunimin gjyqësor në përgjithësi.

Për më tepër, pikat e kontaktit të EJN-së janë të përfshira dhe promovojnë organizimin e sesioneve të trajnimit për bashkëpunimin gjyqësor.

Midis pikave të kontaktit të EJN-së, çdo Shtet Anëtar ka caktuar një Korrespondent Kombëtar, i cili ka një rol koordinues.

EJN ka një Sekretariat të vendosur në Eurojust në Hagë, përgjegjës për administrimin e EJN. Sekretariati i EJN-së siguron funksionimin dhe vazhdimësinë e rrjetit.

## 3. Baza ligjore e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar<sup>1</sup> në çështjet penale në Kosovë

### 3.1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 35 [Liria e Lëvizjes]

1. Shtetasit e Republikës së Kosovës dhe të huajt që janë banorë të ligjshëm të Kosovës, kanë të drejtë të lëvizin lirisht në Republikën e Kosovës dhe të zgjedhin vendbanimin.

---

<sup>1</sup> Korniza Kushtetuese kreu 8.1 (i), dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

KAPITULLI XLVII: PROCEDURA PËR DHËNIEN E NDIHMËS JURIDIKE NDËRKOMBËTARE DHE EKZEKUTIMI I MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE NË ÇËSHTJET PENALE

KAPITULLI XLVIII: PROCEDURA PËR TRANSFERIMIN E TË PANDEHURVE DHE TË DËNUARVE BRENDA DHE JASHTË SHTETIT

Ligji për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale hyri në fuqi më 1 tetor 2011.

2. Secili person ka të drejtë të largohet nga vendi. Kufizimet e kësaj të drejte rregullohen me ligj, nëse ato janë të nevojshme për procedurën ligjore, zbatimin e vendimit të gjykatës ose për të përmbushur obligimin për mbrojtjen e shtetit.
3. Shtetasve të Republikës së Kosovës nuk do t'u ndalohet hyrja në Republikën e Kosovës.

**4.Shtetasit e Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohen nga Kosova kundër vullnetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur me ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare është përcaktuar ndryshe.**

5. E drejta e të huajve për të hyrë në Republikën e Kosovës dhe për t'u vendosur në vend, rregullohet me ligj.

### **3.2 Marrëveshjet bilaterale për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale Marrëveshjet Dypalëshe**

Me vendimin e qeverise se Republikës se Kosovës nr. 26/127 dt.24.04.2013 kemi suksedimin, vazhdimin e zbatimit te marrëveshjeve bilaterale/dypalëshe mes republikës Federative socialiste te Jugosllavisë dhe shteteve tjera qe nuk janë ne kundërshtim me Kushtetutën e republikës se Kosovës.

Marrëveshjet Ndërkombëtare dypalëshe që burojnë nga proceset e përfunduara të Suksedimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe vendeve tjera dhe të cilat lidhën me fushën e Ministrisë së Drejtësisë:

#### **Austria:**

1. Kontrata për Ekstradim, 1 shkurt, 1982;
2. Kontrata lidhur me asistencën e ndërsjelle juridike në çështjet penale, 1 shkurt 1982;
3. Kontrata për zbatimin e ndërsjelle të Vendimeve Gjyqësore për Çështjet Penale 1 shkurt 1982;

#### **Mbretëria e Belgjikës:**

1. Konventa lidhur me Ekstradimin dhe me ndihmën e ndërsjelle gjyqësore në çështjet penale ndërmjet Mbretërisë së Belgjikës dhe Republikës Socialiste të Jugosllavisë, (4 qershor Beograd 1971);

#### **Republika Çeke:**

1. Marrëveshja në mes të RSFJ-së dhe RS të Çekosllovakisë për Rregullimin e Marrëdhënieve Ligjore në Çështjet Civile, Familjare dhe penale (Beograd 20 janar 1964);
2. Traktati në mes të RSFJ-së dhe RS të Çekosllovakisë për Transferimin e ndërsjelle të Personave të Dënuar për arsye të vuajtjes së dënimeve (Pragë 23 maj 1989).

#### **Marrëveshjet pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës:**

### **Republika e Kosovës dhe Mbretëria e Belgjikës:**

1. Marrëveshja për Transferimin e Personave të Dënuar në mes Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës.

### **Republika e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë, kanë nënshkruar tri marrëveshje Dypalëshe:**

2. Marrëveshja për Ekstradim;
3. Marrëveshja për Transferim të Personave të Dënuar; dhe
4. Marrëveshjen për bashkëpunim gjyqësor në çështje penale.

### **Republika e Kosovës dhe ajo e Turqisë, kanë nënshkruar tri marrëveshje Dypalëshe:**

1. Marrëveshja për Ekstradim;
2. Marrëveshja për Transferim të Personave të Dënuar; dhe
3. Marrëveshjen për bashkëpunim gjyqësor në çështje penale.

### **Republika e Kosovës dhe ajo e Maqedonisë, kanë nënshkruar tri marrëveshje për bashkëpunim juridik ndërkombëtar:**

1. Marrëveshja për ekstradim;
2. Marrëveshja për transferim të personave të dënuar; dhe
3. Marrëveshjen për bashkëpunim gjyqësor në çështje penale.

### **Republika e Kosovës dhe Konfederata Zvicerane:**

1. Marrëveshje për Transferimin e Personave të Dënuar.

### **Republika e Kosovës dhe ajo e Kroacisë:**

2. Marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë juridike në çështje penale.

### **Republika e Kosovës dhe Republika e Hungarisë, kanë nënshkruar tri marrëveshje Dypalëshe:**

3. Marrëveshja për Ekstradim;
4. Marrëveshja për Transferim të Personave të Dënuar; dhe
5. Marrëveshjen për bashkëpunim gjyqësor në çështje penale.

### **Republika e Kosovës dhe Republika e Italisë, kanë nënshkruar tri marrëveshje Dypalëshe:**

- Marrëveshja për Ekstradim;
- Marrëveshja për Transferim të Personave të Dënuar; dhe
- Marrëveshjen për bashkëpunim gjyqësor në çështje penale.

### **Republika e Kosovës dhe Republika Federale e Gjermanisë:**

1. Marrëveshja për Bashkëpunim Gjyqësor në çështje penale.

Kjo marrëveshje përfshin fushën e ekstradimit; bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale; transferimin e personave të dënuar; luftën kundër terrorizmit; mbrojtjen e të dhënave personale.

## **Republika e Kosovës dhe SHBA-të:**

### **2. Marrëveshje për Ekstradim.**

#### **Dallimi i marrëveshjes dypalëshe për ekstradim me Shqipërinë dhe SHBA-të nga marrëveshjet tjera dypalëshe për ekstradim.**

#### **Gjuha dhe mënyra e komunikimit**

Kërkesat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar përcillen përmes Ministrisë. Komunikimi përmes kanaleve diplomatike nuk përjashtohet për rastet kur konsiderohet i nevojshëm.

Në rastet urgjente, organi gjyqësor vendor mund të ofrojë ndihmë edhe nëse kërkesa është pranuar drejtpërdrejtë, përmes INTERPOL-it apo në ndonjë mënyrë tjetër që mund të prodhojë dëshmi në të shkruar, me kusht që shteti kërkuar garanton dërgimin e kërkesës në origjinal brenda tridhjetë (30) ditëve përmes MD-së.

Nëse kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë në gjuhë të huaj, ato duhet të shoqërohen me përkthime të verifikuara në gjuhën Shqipe ose Serbe. Përkthimet e vërtetuara në gjuhën Angleze mund të pranohen në bazë të reciprocitetit.

Ministri mund të lejojë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet organeve gjyqësore vendore dhe të huaja, kur konsiderohet e përshtatshme.

#### **Konfidencialiteti**

Ministria, me kërkesën e autoritetit gjyqësor të huaj, ruan konfidencialitetin e kërkesës për bashkëpunim juridik ndërkombëtar dhe informatës së cekur në kërkesë.

### **3.3 Ligji nr. 08/l-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/l-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale**

Ndryshim plotësimi i ligjit ka hyr në fuqi me 26 prill 2022. Ky ligj rregullon kushtet dhe procedurat për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështje penale mes Republikës së Kosovës dhe shteteve të tjera, në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe me marrëveshje ndërkombëtare. Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar mund të realizohet edhe në lidhje me organizatat apo institucionet ndërkombëtare, atëherë kur është i nevojshëm. Në mungesë të një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shtetit të huaj, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar mund të ofrohet mbi bazën e parimit të reciprocitetit. Procedurat gjyqësore të ofrimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar rregullohen me dispozitat e procedurës penale, përveç nëse ndryshe është paraparë me këtë ligj. Republika e Kosovës duhet të zbatoj formalitetet dhe procedurat e përmendura shprehimisht nga shteti kërkuar, nëse formalitetet dhe procedurat e tilla nuk janë në kundërshtim me parimet themelore të së drejtës vendore.

#### **3.3.1 Kufizimet e Bashkëpunimit**

Zbatimi i këtij ligji i nënshtrohet mbrojtjes së interesave të sovranitetit, sigurisë, rendit publik dhe interesave të tjera të Republikës së Kosovës, siç janë të përcaktuara me Kushtetutë.

### 3.3.2 Format e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale

- Ekstradimi
- Ndhimja juridike e ndërsjellë
- Transferimi i procedurës penale
- Ekzekutimi i dënimeve të huaja
- Njohja e vendimeve të huaja penale
- Kontrollimi, ngrirja dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi
- Mbledhja dhe shkëmbimi i informacionit midis shërbimeve të inteligjencës dhe të zbatimit të ligjit
- Forma rajonale dhe nënrajonale ligjore
- Qasja në drejtësi.

Nga të gjitha këto lloje universale të bashkëpunimit, ekstradimi dhe ndihma juridike e ndërsjellë, janë format më të njohura dhe më të zakonshme të bashkëpunimit në praktikë.

## 4. Ekstradimi

### 4.1 Hyrje - Koncepti dhe konsiderata të përgjithshme

Ekstradimi është procesi zyrtar ku një vend dorëzon një person të dyshuar ose të dënuar për një vend tjetër. Ky është një mekanizëm i lashtë, që daton të paktën në shekullin e 13 para Krishtit, kur Faraoni egjiptian ka negociuar një traktat ekstradimi me mbretin e Hititit. Nëpërmjet procesit të ekstradimit, një sovran (shteti kërkues) zakonisht e bën një kërkesë formale tek tjetri sovran (shteti i kërkuar). Nëse personi i kërkuar është gjetur brenda territorit të shtetit të kërkuar, atëherë ky shtet mund ta arrestojë të personin e kërkuarin dhe ai i nënshtrohet procesit të ekstradimit të tij. Krejt kjo në mënyrë që shteti i kërkuar të mund të ndjekë penalisht atë person apo për të zbatuar një dënim tashmë të shpallur nga gjykatat e saj.

Ekstradimi është forma më e vjetër e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale dhe është e njohur si një instrument efektiv të bashkëpunimit ndërkombëtar në zbatimin e ligjit. Si një mjet të bashkëpunimit që drejtpërsëdrejti ndikon në lirinë e individëve, ekstradimi është ndoshta edhe mekanizmi më kompleks dhe ai që ngre sfidat më të madhe, në veçanti në mes të shteteve me tradita të ndryshme ligjore.

### 4.2 Procedura e ekstradimit: vështrim dhe aspekte krahasuese

Procesi i ekstradimit është i qeverisur nga ligji kombëtar i shtetit të kërkuar. Procedurat prandaj ndryshojnë nga një shtet në një tjetër, në një masë më të madhe apo më të vogël, varet nga tradita ligjore e secilit vend. Kjo rezulton në shumë dallime në ligjin pozitiv dhe ligjit procedural të çdo vendi, dallime që pengojnë ekstradimin efikas. Procedura për ekstradim në Kosovë fillon në bazë të kërkesës me shkrim drejtuar ministrisë së drejtësisë së Republikës së Kosovës. Kërkesa për ekstradim duhet të përmbaj veprën penale për të cilën kërkohet ekstradimi dhe shoqërohet nga dokumentet e mëposhtme:

1. Gjeneralitetet e personit të kërkuar, së bashku me të dhëna tjera që do të ndihmonin në vërtetimin e identitetit, shtetësisë dhe vendndodhjes së personit;

2. Originalin apo kopjen e vërtetuar të urdhër arrestit të lëshuar nga organet kompetente të shtetit kërkues, ose nëse personi i kërkuar është i dënuar për ndonjë veprë, origjinalin apo kopjen e vërtetuar të aktgjykimit ose ndonjë shkresë tjetër që përmban dënimin e shqiptuar, faktin që dënimi është i ekzekutueshëm dhe kohëzgjatjen e mbetur të dënimit që do të ekzekutohet. Këto dokumente duhet të përmbajnë kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, rolin e personit në kryerjen e veprës penale dhe kualifikimin ligjor të veprës penale. Nëse dokumentet nuk përmbajnë informata e tilla kërkesa duhet të shoqërohet me një deklaratë në të cilën përshkruhen të dhënat sipas këtij paragrafi;
3. Ekstrakti nga ligji penal i shtetit kërkues, që është i zbatueshëm për çështjen në fjalë;
4. Nëse personi i kërkuar është dënuar në mungesë, duhet të ofrohet një deklaratë me të cilën tregohet se personi është ftuar personalisht apo përmes një përfaqësuesi të autorizuar në bazë të ligjit të shtetit kërkues, për datën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor që ka sjell deri tek marrja e vendimit në mungesë, ose që personi ka deklaruar tek organi kompetent se nuk e kundërshton rastin apo një deklaratë që thekson mjetet juridike në dispozicion të personit për të përgatitur mbrojtjen apo për të kërkuar rigjykimin në prezencë të tij apo saj.

### **4.3 Fazat kryesore të procedurës së ekstradimit**

#### **4.3.1 Arrestimi i përkohshëm para pranimit të kërkesës për ekstradim**

Edhe para pranimit të kërkesës për ekstradim, personi i kërkuar mund të arrestohet dhe paraburgoset për një periudhë maksimale prej dyzetë (40) ditësh, në qoftë se shteti kërkues dorëzon tek ministria kërkesën për arrest të përkohshëm, në të cilën ceket se një kërkesë për ekstradim do të paraqitet në kohën e duhur. Kërkesa për arrest të përkohshëm mund të dërgohet përmes mënyrës elektronike.

Njoftimet e INTERPOL-it “red notice” (njoftimi i kuq), që kërkojnë arrestimin e një personi me qëllim të ekstradimit, si dhe Urdhër Arrestet Evropiane kanë fuqi të njëjtë juridike me kërkesën për arrestim të përkohshëm.

Bazuar në kërkesën për arrestim të përkohshëm, prokurori i shtetit dhe policia kanë të drejtë të arrestojnë personin e kërkuar.

Gjyqtari i procedurës paraprake, sipas detyrës zyrtare, e liron personin nëse kërkesa për ekstradim nuk është pranuar nga gjykata brenda dyzetë (40) ditësh nga dita e arrestimit. Lirimi nuk përjashton mundësinë e arrestimit të serishëm dhe ekstradimitin e tij apo saj nëse kërkesa për ekstradim është pranuar më pas.

**Kërkesat procedurale - Kërkesa për arrest të përkohshëm nuk duhet të ngatërrohet me kërkesën për ekstradim.**

#### **4.3.2 Çfarë është “ RED NOTICE” - njoftimi i kuq?**

Njoftimi i kuq i INTERPOL-t që nga viti 1998, e lejon që një urdhër-arrest kombëtar të shpërndahet në të gjithë botën për forcat policore të shteteve të tjera anëtare të INTERPOL-it, dhe shërben si bazë për arrest të përkohshëm me qëllim të ekstradimit.

Njoftimi i kuq përmban:

- Veçoritë identiteti i personit të kërkuar (statusi martesor, kombësinë, përshkrimi fizik, fotografia, shenjat e gishtave dhe një profil i ADN);
- Informatat e nevojshme për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës nga autoriteti i kërkuar (natyrën e veprës, datën dhe vendin e kryerjes, urdhër arrestin, autoriteti që ka lëshuar urdhër, një përmbledhje të fakteve ku përfshihen elementet thelbësore të veprës);
- Sigurimi se ekstradimi do të kërkohej nga shteti kërkuar pas arrestit të përkohshëm.

### 4.3.3 Çfarë është urdhër arresti evropian ?

Urdhër arresti evropian është miratuar më 13 qershor 2002, dhe zëvendëson procedurat tradicionale të ekstradimit mes shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Vendimi për të nxjerrë një urdhër-arrest evropian bëhet nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar ku kërkohej arrestimi dhe dorëzimi i një personi të kërkuar në një shtet tjetër anëtar, me synim të mund ta ndjekë penalisht ose të bëjë ekzekutimin e një dënimi. Urdhër arresti evropian vë në praktikë parimin e njohjes reciproke. Shtetet anëtare janë të detyruara të njohin vlefshmërinë e urdhër- arresti evropian dhe të ndërmarrin hapat e nevojshme për dorëzimin e personit të kërkuar. Urdhër arresti evropian kapërcen kufijtë dhe ndryshon nga kërkesat për ekstradim pasi që kjo përfshin bashkëpunimin juridik (në kuptimin strikt të fjalës) që vlen për tërë territorin e Bashkimit Evropian. Shqyrtimi i kërkesës i është lënë ekskluzivisht autoritetit gjyqësor dhe ky është trupi i vetëm, nuk është më qeveria ajo që vendos nëse personi i kërkuar duhet apo nuk duhet t'i dorëzohet autoritetit gjyqësor të shtetit tjetër anëtar. Krahasuar me procedurën e ekstradimit tradicional, urdhër-arrestit evropian lehtëson dhe përshpejton procedurën për dorëzimin ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Kërkesa për ekstradim duhet t'i transmetohet brenda një periudhe të caktuar kohore, nëse kërkesa nuk dorëzohet brenda afatit, personi i kërkuar duhet të lirohet. Shumica e traktateve dhe ligjet përcaktojnë se një person i cili është arrestuar në bazë të një kërkesë për arrest të përkohshëm nuk mund të të ndalohej përtej një periudhe kohore të caktuar në qoftë se kërkesa për ekstradim nuk është pranuar.

Kjo periudhë kohore ndryshon: ajo është në mes të 18 dhe 40 ditë për shtetet palë të Konventës Evropiane për ekstradimin, 20 ditë për shtetet palë në Konventë ECOWAS mbi ekstradimin, 30 ditë për shtetet palë të Konventës Ligës Arabe mbi asistencën e ndërsjellë në çështjet penale dhe 60 ditë për shteteve palë të Konventës ndër-amerikane për ekstradim, në Kosovë është 40 ditë.

### 4.4 Shqyrtimi dhe vendimi faza e ekstradimit

Në shumicën e shteteve të botës, procedura e ekstradimit përfshin degët ekzekutive dhe gjyqësore. Në nivel ekzekutiv, kjo zakonisht përfshin ministrin e punëve të jashtme, ministrinë e drejtësisë ose ministrinë e punëve të brendshme.

Kërkesa për ekstradim kështu kalon përmes një niveli zyrtar tek tjetri, mes të cilave nëse ka një mungesë të koordinimit, mund të shkaktojë vonesa të konsiderueshme.

Tradicionalisht, kërkesa për ekstradim është bërë përmes kanaleve diplomatike të ministrisë së punëve të jashtme të shtetit të kërkuar. Shteti i kërkuar në përputhje me ligjin e vet pastaj vendos, të gjitha çështjet që lidhen me procedurën e ekstradimit. Edhe pse duket se organet e gjyqësorit do përshtateshin më mirë se ekzekutivi për të vendosur mbi çështjet që prekin të drejtat civile të personave. Megjithatë, ky nuk është gjithmonë rasti dhe disa qeveri vazhdojnë të caktojnë çështjet

e ekstradimit vetëm tek ekzekutivi, ndërkohë që vendet e tjera i japin kompetencë ekskluzive autoriteteve gjyqësore.

Procedura për ekstradim në Kosovë fillon në bazë të kërkesës me shkrim drejtuar ministrisë së drejtësisë së republikës së Kosovës. Nëse ministria konsideron që kërkesa i plotëson kushtet formale e përcjell atë tek prokuroria themelore kompetente.

Prokuroria themelore në territorin e së cilës personi i kërkuar besohet se banon apo mund të gjendet, është kompetente të merret me kërkesën për ekstradim. Nëse vendndodhja e personit të kërkuar është e panjohur, kërkesa për ekstradim i dërgohet prokurorisë themelore në Prishtinë. Prokuroria themelore menjëherë ndërmerr veprime për identifikimin dhe përcaktimin e vendndodhjes së personit të kërkuar dhe e informon atë lidhur me kërkesën e paraqitur për ekstradimin e tij apo saj.

Prokurori kompetent i shtetit pa vonesë dhe jo më vonë se 3 ditë nga momenti kur personi është identifikuar dhe lokalizuar, paraqet kërkesën për ekstradim në gjykatën themelore në territorin e të cilit gjendet prokuroria themelore kompetente.

#### **4.5 Procedura gjyqësore për ekstradim në Kosovë**

Lejueshmëria e kërkesës për ekstradim shqyrtohet nga kolegji prej tre gjyqtarëve të gjykatës themelore kompetente. Nëse disa kërkesa për ekstradim janë parashtruar nga shtete të ndryshme në lidhje me personin e njëjtë, procedura do të bashkohet. Nëse procedurat janë në pritje nga gjykata të ndryshme, kompetente do të jetë gjykata që e para ka filluar procedurën për atë rast. Gjykata mund të lejojë përfaqësuesin e shtetit kërkues të jetë i pranishëm në procedurë brenda tri (3) ditësh nga data e marrjes së kërkesës për ekstradim, gjykata mban séance dëgjimore në prani të prokurorit të shtetit, personit të kërkuar dhe mbrojtësit të tij. Nëse personi i kërkuar nuk ka mbrojtës, kryetari i trupit gjykues i emëron mbrojtësin sipas detyrës zyrtare. Në fillim të seancës kryetari i trupit gjykues informon personin për të drejtat e tij/saj në bazë të Kushtetutës së republikës së Kosovës dhe Kodit të Procedurës Penale. Gjykata do të marr në pyetje të pandehurin në lidhje me rrethanat e tij apo të saj personale dhe në veçanti në lidhje me shtetësinë e tij/saj. Gjykata do të pyes personin nëse ai ose ajo pajtohet me ekstradimin dhe do të informojë atë për pasojat ligjore të një procedure të thjeshtuar të ekstradimit.

Nëse personi nuk e jep pëlqimin për ekstradimin e thjeshtuar dhe kundërshton ekstradimin, gjykata do ta shtyjë seancën dhe do të japë një afat prej dyzetë e tetë (48) orësh në mënyrë që personi i kërkuar të tregoj arsyet mbi të cilat ai/ajo e kundërshton ekstradimin. Kundërshtimi mund të bazohet vetëm në faktin se personi nuk është personi i kërkuar nga shteti kërkues ose se nuk janë plotësuar kushtet që e lejojnë ekstradimin. Gjykata mund të caktojë një afat tjetër prej dyzetë e tetë (48) orësh për prokurorin që të jetë në gjendje të reagoj ndaj kundërshtimit të bërë nga personi i kërkuar. Nëse vlerësohet se informacioni i dhënë nga shteti kërkues nuk është i mjaftueshëm për të marrë vendim, gjykata mund të paraqes kërkesë në ministri për informata shtesë, e cila pastaj do të adreson kërkesën tek shteti kërkues. Gjykata mund të caktojë një afat kohor për pranimin e saj. Gjykata mund të vlerësoj çdo provë tjetër që e konsideron si të nevojshme. Në rastet kur ndaj personave që kërkohen të ekstradohen, janë duke u zhvilluar procedura penale në republikën e Kosovës, gjykata do ta evidentoj atë në procesverbal dhe po ashtu do ta njoftoj ministrinë. Në këto raste gjykata do të provojë mundësitë e ngrirjes së çdo prone të të pandehurit për të siguruar shpërblimin e palës së dëmtuar sa i përket procedurës penale në republikën e Kosovës.



#### **4.6 Procedura e thjeshtësuar për ekstradim**

Ministria mund të pajtohet që personi i kërkuar të ekstradohet nëpërmjet një procedure të thjeshtuar të ekstradimit me kusht që edhe personi të jep pëlqimin para gjykatës kompetente dhe do të regjistrohet në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duke u siguruar që pëlqimi është dhënë mbi bazën vullnetare dhe se personi është në dijeni për pasojat që do të rrjedhin. Pëlqimi i dhënë nuk mund të tërhiqet.

#### **4.7 Bazat ligjore për ekstradim**

Baza ligjore për ekstradimin mund të jetë një traktat, një marrëveshje ad hoc, parimet e reciprocitetit apo parimet që janë të mbështetura në përgjithësi nga legjislacioni vendas.

#### **4.8 Vendimi për lejueshmërinë apo mos lejueshmërinë e ekstradimit**

Nëse kolegji prej tre gjyqtarësh të gjykatës themelore kompetente gjen se kushtet ligjore për lejueshmërinë e kërkesës për ekstradim janë plotësuar, atëherë nxjerr vendim për lejueshmërinë e ekstradimit. Personi i kërkuar mund të parashtrojë ankesë kundër këtij vendimi në gjykatën e Apelit, brenda tre (3) ditëve nga marrja e vendimit dhe ankesa e shtynë ekzekutimin e vendimit.

Nëse kolegji prej tre (3) gjyqtarëve të gjykatës themelore kompetente gjen se kërkesat ligjore për ekstradim nuk janë përmbushur, nxjerr vendim me të cilin nuk e lejon kërkesën për ekstradim. Prokuroria themelore mund të parashtrojë ankesë kundër këtij vendimi në afat prej tre (3) ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit. Nëse personi është në paraburgim, kolegji prej tre (3) gjyqtarësh, me kërkesë të prokurorisë themelore, mund të vendos që personi të mbetet në paraburgim derisa vendimi për refuzimin e ekstradimit bëhet i formës së prerë.

Pas vendimit të formës së prerë, gjykata themelore kompetente ia dorëzon ministrisë atë dhe çdo vendim tjetër relevant të marrë nga gjykatat.

#### **4.9 Ekstradimi dhe gjykimet në mungesë**

Për vendet që lejojnë gjyqet në mungesë, ekstradimi nuk mund të refuzohet për shkak se individi të cilit i është kërkuar ekstradimi nuk ishte i pranishëm kur dënimi i tij u miratua. Në anën tjetër, për vendet që nuk lejojnë gjykimet në mungesë, ky fakt mund të përdoret si një pengesë për ekstradim mbi bazën e parimit të gjykimet të drejtë. Ato vende konsiderojnë se i akuzuari duhet normalisht të jetë i pranishëm në gjyqin e tij në mënyrë që ti garantohet një gjykim të drejtë. Megjithatë, duhet të theksohet se, në shumë juridiksione, gjëja më e rëndësishme në praktikë është se individi i dënuar në mungesë duhet të ketë pasur mundësinë për të marrë pjesë në gjyqin e tij, shans për të apeluar ose shans t'i nënshtrohet një gjykim të ri për të mundësuar ekstradimin e tij.

### **5. Letër-rreshtimet Ndërkombëtare**

Kjo temë rregullohet me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës gjegjësisht me Kapitullin XXXVII- Procedura për dhënien e letër-rreshtimit dhe shpalljeve publike

## **5.1 Kërkimi i adresës së të pandehurit**

Kur nuk dihet vendbanimi i përhershëm apo i përkohshëm i të pandehurit, kurse me dispozitat e këtij Kodi kjo është e nevojshme, prokurori i shtetit ose gjykata kërkon nga policia që i pandehuri të kërkohet dhe që prokurori i shtetit ose gjykata të njoftohet për adresën e tij.

## **5.2 Kushtet për dhënien e letër-rreshtimit**

1. Letërreshtimi mund të urdhërohet kur i pandehuri gjendet në arrati, e kundër të cilit është filluar procedura penale për veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe për të cilën veprë mund të shqiptohet sipas ligjit dënim me dy (2) apo më shumë vjet burgim dhe kur është lëshuar urdhërarrest ose aktvendim për caktimin e paraburgimit.
2. Letërreshtimi urdhërohet nga gjykata e cila e zbaton procedurën penale. Në procedurë paraprake lëshimi i letërreshtimit urdhërohet nga gjyqtari i procedurës paraprake me propozim të prokurorit të shtetit.
3. Letërreshtimi urdhërohet edhe në rastet kur i pandehuri është arratisur nga institucioni ku mban dënimin, pavarësisht nga lartësia e dënimit, ose kur është arratisur nga institucioni ku mban masën e trajtimit të detyrueshëm që konsiston me heqje lirie. Në këtë rast, urdhrin e lëshon drejtori i institucionit.
4. Letërreshtimi ndërkombëtar mund të kërkohet në cilëndo nga situatat e parapara sipas këtij neni, nga ana e autoritetit përkatës kur personi i kërkuar nuk gjendet në Kosovë ose ka prova se personi banon jashtë Kosovës.
5. Kërkesa e gjykatës ose e drejtorit të institucionit për lëshimin e letërreshtimit ndërkombëtar duhet të dërgohet tek autoritetet kompetente për lëshimin dhe shpërndarjen e tyre.
6. Urdhri i gjykatës ose i drejtorit të institucionit për lëshimin e letërreshtimit i dërgohet policisë për ekzekutim.
7. Policia mban evidencë mbi letërreshtimet e lëshuara. Të dhënat për personat ndaj të cilëve është lëshuar letërreshtim fshihen nga evidenca posa organi kompetent e revokon letërreshtimin.

## **5.3 Shpalljet Publike**

1. Nëse janë të nevojshme informatat për sendet e caktuara lidhur me veprën penale ose këto sende duhet të gjenden, sidomos nëse janë të nevojshme për identifikimin e kufomës së paidentifikuar, organi kompetent i cili e zbaton procedurën, urdhëron shpalljen me të cilën kërkon që informatat dhe njoftimet t'i dërgohen organit kompetent që e zbaton procedurën.
2. Policia mund të publikojë fotografitë e kufomave dhe të personave të zhdukur kur ekzistojnë arsye për dyshim se vdekja apo zhdukja e këtyre personave është shkaktuar me veprë penale.

## **5.4 Tërheqja e letër-rreshtimit ose e shpalljes publike**

1. Organi i cili ka urdhëruar letërreshtimin, letërreshtimin ndërkombëtar ose shpalljen e tërheq atë posa të gjendet personi ose sendi i kërkuar, kur kalon afati i parashkrimit për ndjekje penale ose i ekzekutimit të dënimit, ose kur paraqiten shkaqe të tjera për të cilat letërreshtimi ose shpallja më nuk janë të nevojshme.

2. Urdhri për tërheqjen e letërreshtimit, letërreshtimit ndërkombëtar ose shpalljes duhet të i dërgohet autoritetit kompetent i cili duhet të siguroj anulimin e menjëhershëm të tyre.

### **5.5 Shpallja e letër-rreshtimit ose kërkesës për informata nga publiku**

1. Letërreshtimin dhe shpalljen publike e shpallë organi publik kompetent për punë të brendshme.
2. Për njoftimin e publikut me letërreshtim ose shpallje mund të shfrytëzohen edhe mjetet e informimit publik.
3. Organi kompetent mund të shpallë edhe letërreshtim ndërkombëtar përmes kanaleve ndërkombëtare.
4. Me lutjen e organit të jashtëm, organi kompetent për punë të brendshme mund të lëshojë letërreshtim për personin për të cilin dyshohet se gjendet në Kosovë, me kusht që në lutje të shënohet se në rast se gjendet ky person do të kërkohet ekstradimi i tij.
5. Dispozitat e këtij neni zbatohen përshtatshmërisht edhe në rastet kur policia shpall kërkimin e personave ose sendeve.

### **5.6 Procedurat për lëshimin e Urdhër Kërkimit Ndërkombëtar**

Kërkesa për Urdhër Kërkim Ndërkombëtar duhet ti përmbaj dokumentet në vijim:

1. Nëse ndaj personit i cili kërkohet është duke u zhvilluar ende procedura gjyqësore kërkesës duhet ti bashkëngjitën:
2. Kërkesa e Gjykatës drejtuar Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, të Ministrisë së Drejtësisë për lëshimin e Urdhër Arrestit Ndërkombëtar;
3. Urdhër Arresti i lëshuar nga Gjykata sipas nenit 173 të Kodit të Procedurës Penale;
4. Letër-rreshtimi Qendror sipas neni 535, të Kodit të Procedurës Penale;
5. Aktvendimi për fillimin e hetimeve ose aktakuza.

Kur personi është i dënuar me vendim të formës së prerë nevojiten dokumentet në vijim:

1. Kërkesa e Gjykatës drejtuar Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, të Ministrisë së Drejtësisë për lëshimin e Urdhër Arrestit Ndërkombëtar;
2. Urdhër Arresti i lëshuar nga Gjykata sipas nenit 173 të Kodit të Procedurës Penale;
3. Letër-rreshtimi Qendror sipas neni 535, të Kodit të Procedurës Penale;
4. Vendimi i Gjykatës se shkalles se pare;
5. Vendimi i Gjykatës se shkalles se dyte.

Ju lutem vëreni se pa ndonjërin nga këto dokumente e lartpërmendura Urdhër Arresti Ndërkombëtar është e pamundur të lëshohet.

Përveç tjerash të gjitha dokumentet duhet të jene me vule të njome (ose të rrumbullaket ose të saktësisë), në të kundërtën Interpoli i kthen prapa.

## **6. Transferimi i procedurave penale**

Ky modalitet bashkëpunimi është i parashikuar nga një sërë konventash ndërkombëtare të kohëve të fundit, sidomos Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit. Kjo është një procedurë kur një shtet transferon procedimet penale në shtetin ku gjykata më i përshtatshëm për zgjidhjen e procedurës ndodhet, gjithashtu referohet si *conveniens forum*. Kjo është gjykatë ku është më praktike për të zhvillohen punimet në interes të drejtësisë, për shembull, një gjykatë në shtetin ku akti kryesor i terrorizmit ka ndodhur, ose ku shumica e provave është i koncentruar, duke i besuar dhe lejuar kështu ndjekjen dhe zgjidhjen e një rasti nën juridiksionin e shtetit ku kjo është më e përshtatshme që të kryhet dhe të përfundon procedura. Një gjykatë e tillë mund të jetë gjithashtu në një shtet ku një i dyshuar ndodhet, por nuk mund të ekstradohet, sepse ai ose ajo është shtetas i atij shteti. Procedura transferohet duke u bazuar në një kërkesë zyrtare për qëllime të ndjekjes penale, e cila është akti me të cilin autoritetet kompetente të një shteti që ka juridiksion për të gjykuar një vepër të kërkojë nga autoritetet e një shteti tjetër për të kryer ndjekjen penale.

## **7. Ekzekutimi i dënimeve të huaja: Transferimi i personave të dënuar**

Kjo është një procedurë me të cilën një person i dënuar në territorin e një shteti transferohet në territorin e një shteti tjetër për të shërbyer dënimin e tij ose të saj. Kjo bën të mundur për të lehtësuar rehabilitimin social të shtetasve të huaj të dënuar duke i lejuar ata që të vuajnë dënimet në shtetin e tyre. Kjo gjithashtu ka një objektiv humanitar pasi që ajo sjell personat e tillë fizikisht pranë familjeve të tyre në vendet e tyre. Kjo marrëveshje është dhënë në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, ku dispozitat përkatëse janë më të hollësishme.

## **8. Njohja e vendimeve penale të huaja**

Shtetet historikisht kanë konsideruar se vendimet penale janë një ushtrim i sovranitetit të tyre kombëtar dhe prandaj kanë refuzuar të njohin vendimet e juridiksioneve të huaja. Kjo pozitë është kontradiktore nëse, për shembull, shtetet lejojnë ekstradimin për qëllim të zbatimit të një dënimi mbi bazën e një vendimi të huaj, ekzekutojnë dënimet e huaja dhe bëjnë konfiskimin e produkteve që rrjedhin nga vepra penale. Doktrina ligjore shpjegon se kontradiktë e dukshme ekziston kur duhet bërë një dallim në mes të njohjes së pasojave të një gjykimi dhe njohja e vetë gjykimit. Deri më sot, është vetëm një instrument në nivel rajonal që merret me këtë çështje, përkatësisht konventa evropiane mbi vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale.

## **9. Ndihma e ndërsjellë ligjore në çështjet penale**

### **9.1 Çfarë është ndihma e ndërsjellë ligjore?**

Parimi i sovranitetit të shteteve ndalon seancën gjyqësore në çështjen penale nga ushtrimi i kompetencave të saj përtej kufijve të juridiksionit përkatës dhe nga mbledhja e dëshmive relevante për rezultatin e rastit të vetë në një shtet të huaj.

Gjykata prandaj duhet të kërkojë ndihmën e shtetit të huaj (përveç nëse ky shtet pranon intervenimin në territorin e saj të agjentëve të shtetit në të cilin gjykata është duke vendosur). Ndihma e ndërsjellë ligjore është përcaktuar, pra, si mekanizëm ku shtetet bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në mënyrë që të merren dëshmitë e kërkuara për hetimet dhe ndjekjet penale.

## **9.2 Format kryesore të ndihmës së ndërsjellë juridike**

Një nga avantazhet e ndihmës së ndërsjellë juridike është se ajo mund të marrë forma të ndryshme, nga mbledhja e dëshmive të dëshmitarëve për ofrimin e provave të prekshme, të tilla si deklaratat bankare apo llogaritë e biznesit, për zbatimin e hetimeve. Çdo traktat dhe ligj mbi ndihmën e ndërsjellë ligjore liston llojet e ndryshme të ndihmës që mund të jepen.

### **Cilat janë llojet e veprimit që më së shpeshti kërkohet nga një shtet në mënyrë që të marrë prova ?**

- Marrja e provave ose deklaratave. Shteti kërkues mund të kërkojë që një individ të intervistohet dhe të bëjë një depozitimi, që është, një deklaratë e atij/asaj se çka ka pa, dëgjuar apo mësuar në lidhje me një veprë penale .
- Ndihma në marrjen në dispozicion të autoriteteve gjyqësore të shtetit kërkues personave të paraburgosur apo të tjerëve të japin dëshmi ose të ndihmojnë në hetime.
- Kërkimet për dëshmi në vendbanimin e një personi apo ndonjë vend tjetër përkatës, duke përfshirë kontrollimin e kompjuterëve dhe sistemeve kompjuterike, konfiskimi i pronës dhe ngrirjen e aseteve.
- Ekzaminimi i objekteve dhe vizita e vendeve .
- Dorëzimi apo shërbim i dokumenteve gjyqësore në mënyrë që të marrin, për shembull, një urdhër për ekzekutim apo një vendim.
- Ofrimin e provave, informatave dhe mendimeve të ekspertëve.
- Ofrimin e origjinaleve ose kopjeve të certifikuara të regjistrave dhe dokumenteve përkatëse, duke përfshirë regjistrat qeveritar, bankar, financiar, e korporatave, ose e biznesit.
- Identifikimi ose gjurmimi i të ardhurave nga krimi, pronës, instrumenteve apo gjëra të tjera për qëllim të provave.
- Monitorim, përgjim apo regjistrim të aktiviteteve, lëvizjeve apo komunikimet kompjuterike (duke përfshirë aktivitetet të bazuara kompjuterike dhe telekomunikacionet, qoftë në kohë reale ose pas ngjarjes) e personave të dyshuar për përfshirje në një veprë penale në shtetin kërkues. Vëzhgimet elektronike në përgjithësi i nënshtrohen kontrollit të rreptë gjyqësor dhe dispozitave të shumta ligjore për të parandaluar abuzimin.
- Dërgim i kontrolluar, bëhet kur një shtet lejon dërgesa të paligjshme ose të dyshuara (për shembull, cargot e armëve) për të kaluar jashtë, nëpërmjet ose në territorin e tij nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e autoriteteve të tij kompetente me qëllim të hetimit të një veprë penale dhe identifikimin i personave të përfshirë në kryerjen e veprës.

- Operacionet (hetimet) e fshehta, në të cilën një hetues i zbatimit të ligjit infiltrohet në një organizate kriminale për të mbledhur prova .
- Dhënien e autorizimit të përkohshëm për të hetuesve, prokurorëve apo zyrtarëve të tjerë gjyqësore të shtetit kërkues të hyjë dhe të qëndrojnë në territorin e shtetit të kërkuar me qëllim të shikimit / ekzaminimit të objekteve, vëzhgimin apo intervistimin e personave, për të deklaratat e dëshmitarëve apo edhe marrjen e provave.

### **9.3 Bazat ligjore për ndihmë ligjore të ndërsjellë**

Duke u bazuar në traktatet universale kundër-terrorizmit, është detyrim i shteteve ti ofrojnë njëri-tjetrit masën më të gjerë të ndihmës së ndërsjellë juridike që duhet të kryhet në përputhje me çdo traktat ose marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë juridike që mund të ekzistojë midis tyre. Në mungesë të një traktati ose marrëveshje, shtetet palë duhet ti ofroj një ndihmë tjetër të tillë në përputhje me ligjet e tyre të brendshme.

## **11. Literatura**

1. Korniza Kushtetuese e Kosovës
2. Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
4. Ligji për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale hyri në fuqi më 1 tetor 2011.
5. Ligji për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet penale hyri në fuqi më 17 shtator 2013
6. Ligji Nr. 08/L-026 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-213 Për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar Në Çështjet Penale
7. International cooperation in criminal matters: counter-terrorism – Counter Terrorism Legal Training Curriculum
8. Manual on International Cooperation in Criminal Matters related to Terrorism: Special
9. Emphasis on mutual legal assistance and extradition John E. Harris \*